



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK - GJINEKOLOGJIK
“MBRETERESHA GERALDINE”

Nr. _____ Prot.,

Tirane, __.11.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Per: OE “D E V I S” SH.P.K. NUIS - K31420012M dhe Administrator znj. Kristinka LEKA
*Rruga “Siri Kodra”, Magazina nr. 10, kati 1, ngjitur me “Kozmo Plastika”, prane ish-uzines
“Dinamo”, Tirane.*

* * *

Procedura e prokurimit: **Prokurim Elektronik – Tender i Hapur** - Marreveshje Kuader (48 muaj) - me 1 Operator Ekonomik, kur te gjitha kushtet jane te percaktuara

Numri i references se procedures/lotit: REF-89811-03-11-2021

Pershkrim i shkurter i kontrates: Kryerja e sherbimit te lavanderise dhe hotelerise ne pavionet e S.U.O.GJ. “Mbretresha Geraldine” per nje afat 4 vjeçar (48 muaj), me fond limit 199.936.050 (njqind e nentedhjete e nente milion e nenteqind e tridhjete e gjashte mije e pesedhjete leke) pa TVSH.

Publikime te meparshme (nese zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e perzgjedhjes se fituesit: çmimi me i ulet + oferta ekonomikisht me e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

	Emri i plote i shoqerise	Numri i NIPT-it	Vlera
1	“D E V I S” SH.P.K.	NUIS - K31420012M	199,596,600 Leke pa TVSH (njqind e nentedhjete e nente milion e peseqind e nentedhjete e gjashte mije e gjashteqind)
2	“SANITARY CLEANING” SH.P.K.	NUIS - L42429004B	156,147,000 Leke pa TVSH (njqind e pesedhjete e gjashte milion e njqind e dyzet e shtate mije)
3	“W.CENTER” SH.P.K.	NUIS - K63029402A	Nuk ka paraqitur asnje oferte ekonomike.

Jane s’kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

Pas shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit te hedhur ne sistem nga OE si dhe verifikimit ne terren te pajisjeve/makinerive te deklaruar nga OE, KVO e ngritur me urdhrin nr. 212/2, date 11.03.2021 ka skualifikuar OE e meposhtem:

	Emri i plote i shoqerise	Numri i NIPT-it	Arsyet e skualifikimit:
1	"SANITARY CLEANING" SH.P.K.	NUIS - L42429004B	OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K. eshte skualifikuar nga KVO per arsye se: (1) nuk i permbushte te gjitha kriteret e pergjithshme te kualifikimit dhe me konkretisht kriterin e percaktuar ne shtojcen 7 te DT, duke çuar njekohesisht ne pamundesine e verifikimit nga KVO te faktit nese ndonjeri prej personave perkates (perfaqesues te OE) ka qene apo jo i denuar me pare per ndonje nga veprat penale te percaktuara ne nenin 45 te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar; (2) nuk i permbushte te gjitha kriteret e veçanta te kualifikimit, te percaktuara ne piken 3.3 "kapaciteti teknik", te DT dhe me konkretisht nuk permbush kriteret e percaktuara ne piken 3.3.8 (ne lidhje me fuqine punetore) dhe piken 3.3.11 (ne lidhje me pajisjet/makinerite) pasi: (i) nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K. rezultoi qe ky OE kishte 0 (zero) punonjes te kategorise "punetore ngarkim shkarkimi" nga 2 (dy) punetore te kesaj kategorie qe kerkohej sipas DT; (ii) nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K., dhe verifikimit ne terren te pajisjeve/makinerive te deklaruar, KVO konstatoi qe pothuajse per te gjitha keto pajisje/makineri nuk mund te behej lidhja e tyre me dokumentacionin e paraqitur ne sistem nga OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K. si psh deklaratat e zhdoganimit, faturat tatimore te shitjes, etj (pra nuk mund te evidentohet qe behej fjale pikerisht per pajisjet e evidentuara ne terren); (iii) nga verifikimi ne terren i pajisjeve/makinerive te OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K., KVO konstatoi qe peshorja elektronike e markes "STEINBERG" me nr. serial SB9-PF-300/50, prodhuar ne Poloni, pa vit prodhimi, nuk ishte ne gjendje funksionale pune (pranuar dhe nenshkruar nga vete OE ne procesverbalin e mbajtur nga KVO ne terren) dhe madje sipas dokumentacionit te paraqitur OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K. rezultonte qe te kishte bere kualidimin e kesaj pajisje perpara se ta blinte ate; (iv) nga verifikimi ne terren i pajisjeve/makinerive te OE "SANITARY SCEANING" SH.P.K., rezultoi qe disa prej tyre nuk i plotesonin kriteret e percaktuara ne piken 3.3.11 dhe ne Shtojcen nr. 9 te DT,

2	“W.CENTER” SH.P.K.	NUIS - K63029402A	OE “W.CENTER” SH.P.K. është skualifikuar nga KVO per arsye se ky OE kishte hedhur ne sistem vetem nje dokument me emertimin “VERTETIM_TATIME_DT_01.11.2016” dhe per rrjedhoje KVO arriti ne konkluzionin qe ky OE nuk permbushte asnje prej kriterëve te pergjithshme dhe te veçanta te kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojme OE “D E V I S” SH.P.K., me NUIS - K31420012M** dhe Administrator znj. Kristinka LEKA dhe me adresë: “Rruga “Siri Kodra”, Magazina nr. 10, kati 1, ngjitur me “Kozmo Plastika”, pranë ish-uzines “Dinamo”, Tirane.” **se oferta e paraqitur nga ky OE**, me një vlerë të përgjithshme prej 199,596,600 Leke pa TVSH (njqind e nentëdhjetë e nente milion e pesëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë S.U.O.GJ. “Mbretresha Geraldine” sigurimin e kontratës, siç parashikohet në piken 4.2 dhe Shtojcën nr. 20 të DT, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këto kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertes suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorezuar me një vlerë të përgjithshme prej: -, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr. 9643 datë 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.10.2021

Ankesa: **Po**

(nese ka) ka marrë përgjigje në datë:

Në lidhje me vlerësimin e bërë në sistem nga KVO, OE “SANITARY CLEANING” SH.P.K. ka paraqitur ankesën nr. 221/33 prot., datë 27.10.2021, e cila është refuzuar nga S.U.O.GJ. “Mbretresha Geraldine” përmes vendimit nr. 212/36 prot., datë 03.11.2021, njoftuar OE “SANITARY CLEANING” SH.P.K me datë 03.11.2021 përmes shërbimit postar (objekti postar me nr. RR657278800AA) për të cilin OE “SANITARY CLEANING” SH.P.K. nuk ka paraqitur asnjë ankesë në KPP.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eliona DEMALIAJ